



THELLOHET KRIZA INSTITUCIONALE NË KOSOVË

FAQE 4-5

Opozita shton presionin për vazhdimin e seancës konstituive, refuzon takimin me Haxhiun



PDK-ja, LDK-ja dhe Aleanca kanë shtuar presionin për vazhdimin e seancës konstituive të Kuvendit. Këto parti kanë refuzuar takimin me Albulena Haxhiun, i cili është planifikuar të mbahet sot. Deputetët e PDK-së edhe të hënën kanë mbajtur

një aksion para qeverisë, duke kërkuar nga Albin Kurti të kthehet në Kuvend. Eliza Hoxha dhe Vlora Çitaku kanë kërkuar nga Kurti të kontribuojë në zhblokimin e institucioneve. Ndërsa Kurti ka shmangur komentet lidhur me zhvillimet politike në vend.

Në anën tjetër, kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, ka thënë se takimet i zhvillojnë me kryetarët e partive politike. Kurse Besnik Tahiri ka paralajmëruar se Aleanca do t'i shqyrtojë veprimet politike në ditët dhe javët e ardhshme

GLPS-ja: HESHTJA E QEVERISË NË DETYRË PËRBËN SHKELJE TË DETYRIMEVE LIGJORE DHE PARIMEVE TË TRANSPARENCËS

F. 3



HASANI: NGËRÇI I KUVENDIT, 'NJOLLË E ZEZË' NË HISTORINË POLITIKE DHE KUSHTETUESE TË KOSOVËS

F. 5



AKTUALE



'HAPJA E URËS SË IBRIT, HAP HISTORIK DREJT LUFTIMIT TË TENDENCAVE TË SERBISË'

F. 7

ZEMAJ: QINDRA PACIENTË ME KANCER PO DETYROHEN T'I BLEJNË VETË BARNAT

F. 6

152 LINDJE NË GJINEKOLOGJINË E QKUK-SË GJATË NJË JAVE, NË MESIN E TYRE 5 BINJAKË

F. 6

EKONOMI



DOGANA E KOSOVËS ARKËTON MBI 1.15 MILIARD EURO TË HYRA PËR SHTATË MUAJ

F. 8

KURTI: SYNOJMË TA TRANSFORMOJMË EKONOMINË DHE TA FORCOJMË PRODHIMIN VENDOR

F. 8

SPORT



SHUHEN DY EMRA EMBLEMATIKË TË FUTBOLLIT TË KOSOVËS, ERDOGAN CELINA DHE ZENUN BROVINA

F. 11

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Kallas: BE-ja po përgatit paketën më ambicioze të sanksioneve ndaj Rusisë

BRUKSEL, 17 GUSHT - Shefja e politikës së jashtme e Bashkimit Evropian (BE), Kaja Kallas, ka paralajmëruar një paketë të re sanksionesh ndaj Rusisë, e cila, sipas saj, do të jetë më ambiciozja që nga fillimi i luftës në Ukrainë.

Në një intervistë për gazetën gjermane "Die Welt", Kallas ka thënë se gjatë vjeshtës do të propozojë një listë të re masash, me synim zgjerimin e

ndjeshëm të numrit të subjekteve ruse që i nënshtrohen sanksioneve të BE-së. "Këtë vjeshtë, unë po propozoj listën më ambicioze të sanksioneve që nga fillimi i luftës. Pasi të miratohen, këto masa do ta rrisin menjëherë numrin e përgjithshëm të subjekteve ruse që i nënshtrohen sanksioneve me një të tretën", ka deklaruar Kallas.

Sipas përfaqësueses së lartë të BE-së për Politikën e Jashtme dhe Sigurinë, sanksionet e vendosura që prej pushtimit rus të Ukrainës në shkurt të vitit 2022 kanë shkaktuar kosto të konsiderueshme për Moskën.

Kallas ka pretenduar se masat e BE-së i kanë kushtuar Rusisë më shumë se një trilion euro, duke kufizuar burimet në dispozicion të makinës së saj të

luftës. Paketa e re pritet të zgjerojë më tej presionin ekonomik dhe financiar ndaj subjekteve ruse, në një kohë kur Bashkimi Evropian vazhdon të kërkojë mënyra për të dobësuar kapacitetet e Moskës për financimin e luftës në Ukrainë. Propozimi i Kallas do të duhet të miratohet nga shtetet anëtare të Bashkimit Evropian përpara se masat e reja të hyjnë në fuqi.



PARLAMENTI IRANIAN AVANCON PROJEKTLIGJIN QË KRIMINALIZON KONTAKTET ME MEDIET E HUAJA

TEHERAN, 17 GUSHT - Parlamenti iranian, i dominuar nga konservatorët e vijës së ashpër, ka miratuar kuadrin e një projektligji që kriminalizon një sërë ndërveprimesh me mediat e huaja "armiqësore" dhe institucione të tjera me lidhje jashtë vendit.

Masa, e miratuar më 16 gusht nga 183 deputetë në parlamentin me 290 vende, ndalon dhënien e intervistave, pjesëmarrjen në diskutime apo komunikime të tjera me media të përshkruara si amerikane, izraelite ose të financuara nga Shtetet e Bashkuara apo Izraeli. Projektligji do ta bënte gjithashtu vepër penale dërgimin e videove, fotografive, regjistrimeve audio ose të dhënave të tjera te media joiraniane apo te persona të angazhuar në veprimtari mediatike jashtë vendit.

Krijimi i këtij kuadri të ri për ndjekjen penale të ndikimit të dyshuar të huaj vjen në një kohë kur gazetarët dhe persona të tjerë të akuzuar se mbajnë kontakte me organizata të konsideruara armiqësore nga Teherani po përballen me një shqyrtim gjithnjë e më të madh.

Dënime me burg për shkeljet

Analisti politik me bazë në Finlandë, Kambiz Ghafouri, i ka thënë Radios Farda, shërbim në gjuhën persiane i "Radios Evropa e Lirë", se shkeljet e parashikuara në projektligj do të dënohenin me gjashtë muaj deri në dy vjet burg. Sipas tij, masa mund ta "kthejë Iranin në Korenë e Veriut". "Përshkallëzimi



i infiltrimit nuk ndodh në shoqëri, por në strukturën e pushtetit... Në vend që të merren me aparatën e sigurisë, ata po godasin gazetarët", ka thënë Ghafouri.

Ai ka shtuar se, nëse autoritetet do të kërkonin vërtet boshllëqe në sigurinë kombëtare, "do të duhej të mbanin përgjegjësi vetë". Fusha e gjerë e legjislacionit shtrihet edhe në jetën kulturore dhe akademike. Kontaktet me media të tjera të huaja do të kërkonin njoftim paraprak të Ministrisë së Inteligjencës përmes një sistemi qeveritar, duke u kërkuar në praktikë iranianëve të informonin autoritetet para se të jepnin një intervistë.

Legjislacioni përcakton Ministrinë e Inteligjencës dhe

degën e inteligjencës së Gardës Revolucionare Islamike (IRGC) si organet përgjegjëse për hetimin e shkeljeve të dyshuara. Masa të tjera të miratuara nga parlamenti parashikojnë ndalimin e përjetshëm të prodhimit ose regjisë së filmave, dokumentarëve, shfaqjeve teatrale, muzikës ose librave që promovojnë "kulturën antiislame" ose paraqesin vendin në mënyrë negative. Projektligji synon gjithashtu veprimtaritë arsimore dhe kërkimore, duke parashikuar pesë deri në 10 vjet burg për organizatorët e kurseve ose seminareve që konsiderohen "të papajftueshme me kulturën iraniane", ndërsa pjesëmarrësit mund të dënohen me deri në dy vjet burg. Gjithashtu, çdo

bashkëpunim akademik i paaautorizuar me universitete ose institute kërkimore të huaja, pa miratimin e Ministrisë së Inteligjencës, do të dënohet me gjashtë muaj deri në dy vjet burgim. "Edhe shkenca duhet të kalojë përmes censurës së sigurisë", ka thënë Ghafouri, duke akuzuar autoritetet se po përpiqen t'i izolojnë iranianët dhe "t'u mbyllin gojën".

Projektligji duhet të miratohet nga organi mbikëqyrës kushtetues, Këshilli i Gardianëve, për t'u kthyer në ligj. Irani tashmë vendos kufizime të gjera ndaj gazetarisë së pavarur dhe qasjes në informacion. Ai ka zhvilluar gjithashtu një fushatë vdekjeprurëse, duke përdorur ato që organizatat për të drejtat e

njeriut thonë se janë pothuajse gjithmonë akuza të fabrikuara ose të ekzagjeruara për "spiunazh", për të ekzekutuar persona që shihen si kritikë ndaj autoriteteve.

Iran Human Rights ka thënë se deri më tani këtë vit ka verifikuar të paktën 472 ekzekutime, duke nxitur shëfën e OKB-së për të drejtat e njeriut, Kurt Volker, të akuzojë autoritetet se po përdorin dënimin me vdekje "për të ngjallur frikë te popullsia dhe për të shtypur mospajtimin". Reporterët pa Kufij e rendisin Iranin në vendin e 177-të nga 180 vende në Indeksin Botëror të Lirisë së Shtypit 2026, duke përmendur arrestimet, mbikëqyrjen, ngacmimet, censurën dhe dënimet e rënda me burg ndaj gazetarëve.

Trumpi mirëpret marrëveshjen e përbashkët të mbrojtjes së Mekës: Hap i guximshëm dhe i rëndësishëm

UASHINGTON, 17 GUSHT - Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA), Donald Trump, ka mirëpritur nënshkrimin e marrëveshjes së përbashkët të mbrojtjes së Mekës nga Turqia, Pakistani

dhe Arabia Saudite. "Shumë i lumtur që shoh se Arabia Saudite, Turqia dhe Pakistani kanë nënshkruar së fundmi dhe më në fund Marrëveshjen e Përbashkët të Mbrojtjes së Mekës", ka shkruar Trumpi

në platformën e tij "Truth Social".

Trumpi ka thënë se marrëveshja tregon "si Lindja e Mesme po bashkohet dhe se si vendet më në fund do të jenë në gjendje të mbrojnë veten në

një mënyrë më kuptimplote". "Urime udhëheqjes së madhe të tre kombeve të përmendura. Ky është një hap i parë i madh, i guximshëm dhe i rëndësishëm - wow!", ka shkruar Trumpi.



TAHIRI: ALEANCA DO TA DËRGOJË NË PROKURORI ÇËSHTJEN E 18 KOMISIONEVE TË THEMELUARA NGA QEVERIA

PRISHTINË, 17 GUSHT - Shefi i deputetëve të Aleancës, Besnik Tahiri, ka bërë me dije se kjo parti do ta dërgojë në prokurori çështjen e vendimeve të qeverisë në detyrë për themelimin e 18 komisioneve, të cilat, sipas tij, janë krijuar për emërime në agjenci ekzekutive e qeveritare dhe në pozita publike.

Tahiri e ka akuzuar qeverinë në detyrë se po vazhdon me emërime, edhe pse, sipas tij, nuk ka legjitimitet për të ndërmarrë veprime të tilla, ndërsa ka kërkuar që këto vendime të anulohen menjëherë. “Qeveria e Republikës së Kosovës ka marrë 18 vendime, duke themeluar 18 komisione, diku me njerëz të njëjtë, për t’i emëruar në agjenci ekzekutive, në agjenci qeveritare, në një pozitë si sekretar permanent, në një kohë kur kjo qeveri është në detyrë, kur kjo qeveri nuk ka

legjitimitet, kur kjo qeveri është duke e bllokuar shtetin, kur këta ministra e shkelin ligjin për qeveri, duke ardhur të betohen si deputetë në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe prej këtu duke hyrë për detyrën e duhur të tyre dhe duke shkuar në ministri. Pra, në qoftë se e shohim ligjin për qeveritë që e kam këtu, neni 31, që flet për kufizimet e qeverisë në dorëheqje, e neni 1.3 thotë kështu”, ka thënë ai.

Sipas Tahirit, qeveria në detyrë nuk duhet të zhvillojë procedura të reja për emërime në pozita publike, ndërsa ka paralajmëruar se çështja do të trajtohet edhe në aspektin juridik. “Procedura të reja për emërimin në pozita publike, për emërimin e të cilave është kompetencë në bazë të ligjeve përkatëse. Le që po vazhdojnë me bërë emërime. Le që po vazhdojnë me bërë komisione, mirëpo edhe po përgatiten që



jo vetëm në nivel politik, të shkeljes së ligjit të betimit të deputetit, ta shkelin Kushtetutën, mirëpo po ashtu edhe në administratën e shtetit”, ka deklaruar ai.

Më tutje, Tahiri ka thënë se Aleanca nuk do të lejojë, siç ka thënë, që administrata shtetërore të vihet në funksion të një partie dhe ka paralajmëruar kallëzim penal ndaj personave përgjegjës. “Nuk guxojmë asnjë qeveri, e as kjo

që nuk ka legjitimitet, që ta kthejë administratën e shtetit në funksion të një partie. Dje kemi thënë që si Aleancë nuk do të lejojmë që të kemi një parti-shtet dhe sot po ju themi që kjo logjikë duhet të ndalet menjëherë. Këto vendime të jashtëligjshme duhet të anulohen menjëherë, përdërisa këta anëtarë të komisionit që marrin pjesë në një procedurë të jashtëligjshme duhet të kenë

shumë kujdes, për shkak se Aleanca këtë çështje do ta ngrejë në Prokurorinë përgjegjëse, duke e trajtuar këtë temë përmes një kallëzimi penal, për shkak se kjo është mënyra e vetme e jona që të pengojmë një kapje të shtetit në formën më flagrante të mundshme”, është shprehur ai. Tahiri ka deklaruar se kjo nuk është e vetmja çështje për të cilën, sipas tij, ka shkelje dhe ka paralajmëruar se do të ngrihen edhe raste të tjera që lidhen me ushtrimin e funksioneve të dyfishta nga deputetët e betuar. “Ditën në vijim do të ngrihen edhe raste të deputetëve të tjerë. Për shkak se nuk ka shkelje vetëm në këtë pikë. Ka shkelje edhe në pika të tjera... Pastaj, ka të bëjë me shkeljen tjetër që ndërlidhet me funksionet e dyfishta që deputeti i betuar e ushtron edhe në një zyrë ku nuk do të duhej të hynte”, ka deklaruar Tahiri.

GLPS-JA: HESHTJA E QEVERISË NË DETYRË PËRBËN SHKELJE TË DETYRIMEVE LIGJORE DHE PARIMEVE TË TRANSPARENCËS

PRISHTINË, 17 GUSHT - Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) ka shprehur shqetësim lidhur me, siç ka vlerësuar, shpërfilljen e obligimeve ligjore dhe mungesën e transparencës nga qeveria në detyrë, pas kërkesës së kësaj organizate për qasje në dokumente publike. GLPS-ja ka bërë me dije se kërkesa, drejtuar Zyrës së Kryeministrit (ZKM), ka pasur të bëjë me dorëheqjet e anëtarëve të qeverisë në detyrë, të cilët janë zgjedhur deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Përmes një reagimi publik, GLPS-ja ka njoftuar se më 6 gusht 2026 ka parashtruar kërkesën, duke kërkuar listën e anëtarëve të qeverisë që kanë dhënë dorëheqje, datat e



dorëheqjeve dhe vendimet përkatëse për pranimin e tyre. “Kërkesa është parashtruar duke u bazuar në paragrafin 1 të nenit 26 të Ligjit për qeverinë, sipas të cilit, në rast se një anëtar i Qeverisë në detyrë zgjidhet deputet, ai duhet të japë dorëheqje nga posti i ministrit para ditës së certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve. Po ashtu, neni 72 i Kushtetutës ndalon ushtrimin e njëkohshëm

të funksionit të deputetit dhe ministrit. Kjo çështje është trajtuar edhe nga Gjykata Supreme në vendimin P.A.nr.09/2025, të datës 25 qershor 2025, ku është konstatuar se ushtrimi i njëkohshëm i këtyre dy funksioneve është në kundërshtim me Kushtetutën”, është thënë në reagimin e GLPS-së.

Sipas GLPS-së, përkundër obligimit ligjor dhe rëndësisë së kësaj çështjeje, ZKM-ja nuk i është përgjigjur kërkesës brenda afatit prej shtatë ditësh, të përcaktuar me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike. Mungesa e përgjigjes, sipas GLPS-së, nuk përbën vetëm shkelje të afatit ligjor për qasje në dokumente publike, por cenon

edhe parimin e transparencës institucionale. “Për një çështje që lidhet drejtpërdrejt me respektimin e Kushtetutës dhe ligjit, institucionet publike duhet të jenë transparente edhe pa u detyruar nga kërkesat për qasje, e aq më tepër të mos refuzojnë apo heshtin kur një informacion i tillë kërkohet në mënyrë formale”, është thënë në reagimin e GLPS-së. Për këtë arsye, GLPS ka bërë me dije se, më 17 gusht 2026, ka parashtruar ankesë në Agjencinë për Informim dhe Privatësi (AIP), duke kërkuar që ZKM-ja të obligohet të ofrojë informacionet dhe dokumentet e kërkuara. “Moszbatimi i detyrimeve të përcaktuara me ligj dhe heshtja institucionale

ndaj kërkesave të ligjshme të publikut nuk mund të normalizohen si praktikë dhe institucionet janë të detyruara të veprojnë në përputhje me ligjin dhe të japin llogari për veprimet dhe mosveprimet e tyre”, është thënë në reagimin e GLPS-së. GLPS-ja ka vlerësuar se një qasje e tillë përbën mungesë serioze të përgjegjësisë dhe transparencës institucionale ndaj shoqërisë civile dhe publikut në përgjithësi. Në fund, GLPS-ja i ka bërë thirrje Qeverisë që, pa vonesa të mëtejshme, ta informojë opinionin publik për këtë çështje dhe t’i bëjë publike informacionet dhe dokumentet përkatëse, në përputhje me detyrimet ligjore për transparencë dhe llogaridhënie.

NISMA E IKD-së PËR NDRYSHIMIN E KODIT PENAL, HOTI: T’I MBAJME PËRGJEGJËS PERSONAT QË NUK I ZBATOJNË VENDIMET E KUSHTETUESES

PRISHTINË, 17 GUSHT - Instituti Kosovar për Drejtësi (IKD) ka vazhduar mbledhjen e nënshkrimeve për peticionin që synon ndryshimin e Kodit Penal të Kosovës, me qëllim që përdorimi i parasë publike gjatë periudhës së fushatës dhe parafushatës zgjedhore të përcaktohet si vepër penale. Nismën e ka mbështetur edhe ish-kryeministri dhe deputeti i LDK-së, Avdullah Hoti, ndërsa IKD-ja u ka bërë thirrje qytetarëve t’i bashkohen peticionit, i cili synon forcimin e zbatimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese Jakaj ka thënë se peticioni po

shkon mirë dhe se është mbështetur nga dhjetëra organizata të shoqërisë civile, odat ekonomike, njerëz dhe aktorë kryesorë në Republikën e Kosovës, në mesin e tyre edhe deputetë të Kuvendit të Kosovës.

“Peticioni po shkon mirë, e kanë mbështetur me dhjetëra organizata të shoqërisë civile, të odave ekonomike, të njerëzve dhe, mes akterëve kryesorë në Republikën e Kosovës, në mesin e tyre edhe deputetë të Kuvendit të Kosovës. Sot me ne nismën e ka përkrahur, sapo e ka përkrahur edhe ish-kryeministri, zoti Hoti, deputeti



i tanishëm i legjislaturës së 11-të, të cilin e falënderojmë për këtë mbështetje”, ka thënë Jakaj. Jakaj ka bërë me dije se mbledhja e nënshkrimeve do të vazhdojë gjatë dy ditëve në vazhdim në Prishtinë dhe në qytete të tjera. “Ne do të jemi sot deri në orën 3:00 dhe do të jemi

dy ditë në vazhdim në Prishtinë edhe në qytete të tjera, ku i ftojmë qytetarët të bëhen pjesë e kësaj nisme”, ka thënë ai.

Ndërsa Avdullah Hoti e ka përgëzuar IKD-në për këtë nismë, duke thënë se ndryshimi legjislativ mund të jetë i domosdoshëm në frymën e zhvillimeve të dy viteve të fundit. “Faleminderit! Unë dëshiroj që t’ju përgëzoj për këtë nismë. Po duket që, në frymën e zhvillimeve të dy viteve të fundit, ndoshta është i domosdoshëm ky ndryshim legjislativ. Sjelljet e partive të caktuara politike kanë qenë jashtë standardeve me të cilat ne jemi mësuar dhe i kemi

vendosur nga viti 2008 e këndeje, që sa herë që ka pasur aktgjykime të Gjykatës Kushtetuese, ato janë zbatuar pa asnjë përjashtim, bile as nuk i kemi komentuar si aktgjykime të tilla”, ka thënë Hoti.

Hoti ka thënë se në dy vitet e fundit, e veçanërisht ditët e fundit, është dalë jashtë këtij standardi. “Ndërkohë që në dy vitet e fundit dhe, në veçanti, tash ditët e fundit, kemi dalë jashtë këtij standardi dhe është e domosdoshme që, sipas ligjit, t’i mbajmë përgjegjës personat që nuk i zbatojnë vendimet e Gjykatës Kushtetuese”, ka deklaruar Hoti.

THELLOHET KRIZA INSTITUCIONALE NË KOSOVË

Opozita shton presionin për vazhdimin e seancës konstituive, refuzon takimin me Haxhiun



PDK-ja, LDK-ja dhe Aleanca kanë shtuar presionin për vazhdimin e seancës konstituive të Kuvendit. Këto parti kanë refuzuar takimin me Albulena Haxhiun, i cili është planifikuar të mbahet sot. Deputetët e PDK-së edhe të hënën kanë mbajtur një aksion para qeverisë, duke kërkuar nga Albin Kurti të kthehet në Kuvend. Eliza Hoxha dhe Vlora Çitaku kanë kërkuar nga Kurti të kontribuojë në zhbllokimin e institucioneve. Ndërsa Kurti ka shmangur komentet lidhur me zhvillimet politike në vend. Në anën tjetër, kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, ka thënë se takimet i zhvillojnë me kryetarët e partive politike. Kurse Besnik Tahiri ka paralajmëruar se Aleanca do t'i shqyrtojë veprimet politike në ditët dhe javët e ardhshme

EPOKA
ERE

Lirim GECI

PRISHTINË, 17 GUSHT - Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Aleanca kanë shtuar presionin për vazhdimin e seancës konstituive të Kuvendit, duke kërkuar që partitë politike të fokusohen në zhbllokimin e institucioneve dhe konstituimin e Kuvendit. PDK-ja ka vazhduar edhe të hënën aksionin para objektit të Qeverisë së Kosovës, duke bllokuar hyrjen në shenjë proteste ndaj mosvazhdimin të seancës konstituive. PDK-ja ka paralajmëruar se do t'i dërgojë sërish letër kryesuesit të seancës konstituive, Avni Dehari, për të kërkuar vazhdimin e saj. Deputetja e PDK-së, Eliza Hoxha, ka deklaruar se qëllimi i aksionit është që kryeministri në detyrë, Albin Kurti, të kthehet në Kuvend dhe të kontribuojë në konstituimin e tij. "Jam këtu bashkë me krejt kolegët e mi nga

Partia Demokratike e Kosovës për të bërë një pyetje të vetme për deputetin Kurti, i cili ka uzurpuar pozitën e kryeministrit bashkë me ministrat e tij. Që nga dita kur e kanë dhënë betimin si deputetë, jo, por që nga certifikimi i rezultateve, ata qëndrojnë ilegalisht në pozicionet të cilat i ushtrojnë edhe sot, për çka dhe ne jemi mbledhur sot këtu për të mos e lejuar hyrjen e tij në zyrat e Kryeministrit", ka deklaruar Hoxha. Hoxha ka kërkuar nga Kurti që, në vend të bllokimit të Kuvendit, të marrë pjesë në seancën konstituive dhe ta propozojë kandidatin për kryetar të Kuvendit. "Zotëri Kurti duhet ta kuptojë që, në vend se ta sabotojë Kuvendin, të vijë aty të krijojë mundësi për ta konstituuar Kuvendin. Ai është qëllimi parësor dhe puna e tij parësore që duhet ta bëjë si fitues i zgjedhjeve të fundit. Ta propozojë emrin dhe të ecim

përpara për themelimin e institucioneve të legjislaturës", ka thënë ajo. Sipas Hoxhës, asnjë subjekt politik nuk mund të jetë mbi shtetin dhe Kushtetutën e Kosovës. "Për më tepër, ai sot qëndron si uzurpator në zyrat e kryeministrit bashkë me të gjithë ministrat e tij dhe një gjë duhet ta dinë edhe qytetarët dhe të gjithë të tjerët që nuk jetojnë në Kosovë, por kontribuojnë çdo ditë për Kosovën: ai nuk mund të jetë mbi shtetin e Kosovës, partia e tij nuk mund të jetë mbi shtetin e Kosovës dhe mbi Kushtetutën e Kosovës. Andaj, i bëjmë thirrje sa më parë që të kthehet në Kuvend, aty ku e kemi vendin, për ta nisur legjislaturën e 11-të dhe për t'u kthyer në rendin kushtetues dhe në normalitet në shtetin e Kosovës", ka deklaruar Hoxha. Ndërsa deputetja tjetër e PDK-së, Vlora Çitaku, ka kërkuar që Albin Kurti të shkojë në Kuvend dhe të hapë rrugën për rikthimin e rendit kushtetues. "Albin, eja në Kuvend dhe hape rrugën për

rikthimin e rendit kushtetues. Mos e mbaj peng shtetin, institucionet dhe interesin e qytetarëve për kalkulimet e tua politike!", ka thënë Çitaku. Në të njëjtën kohë, për sot (e martë) në orën 9:00 ushtruesja e detyrës së presidentes së Kosovës, Albulena Haxhiu, i ka ftuar përfaqësuesit e partive politike në takim për të diskutuar mundësinë e arritjes së një marrëveshjeje për zgjedhjen e presidentit të vendit. Megjithatë, takimi i thirrur nga Haxhiu është refuzuar nga PDK-ja, ndërsa LDK-ja dhe Aleanca kanë kërkuar që fillimisht të zhbllokohet procesi i konstituimit të Kuvendit.

Ditë më parë kryesuesi i seancës konstituive, Avni Dehari, ka thënë se nuk do ta thërrasë seancën pa një marrëveshje politike në mes të partive parlamentare. "Çdo përpjekje për ta vazhduar seancën pa një marrëveshje politike vetëm sa e tensionon më tej situatën dhe e rrit rrezikun e përplasjeve, madje edhe të konfliktit fizik brenda sallës së Kuvendit. Pas qëndrimit të ri të LDK-së, mirëpres ftesat për takime të kryetarit të Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, si dhe ftesat e ushtrueses së detyrës së presidentes, znj. Albulena Haxhiu, për partitë politike për një takim konsultativ. Kosova ka nevojë për përgjegjësi politike, dialog dhe për një marrëveshje që e zhblllokojë situatën institucionale dhe garantojë

funkcionimin e qëndrueshëm të institucioneve. Prandaj, si kryesues i seancës konstituive u bëj thirrje të gjitha partive politike që të ulen së bashku, ta marrin përgjegjësinë që u takon dhe ta gjejnë zgjidhjen politike që i hap rrugë konstituimit të Kuvendit, formimit të qeverisë dhe marrëveshjes për presidentin konsensual. Konstituimi i Kuvendit dhe formimi i qeverisë pa një marrëveshje paraprake për presidentin nënkupton zgjedhje të parakohshme, diçka që duhet ta evitojmë", ka thënë Dehari.



Kurti nuk flet për situatën politike

Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, ka refuzuar t'i komentojë zhvillimet e fundit politike në vend, duke u fokusuar vetëm në projektin e Parkut Industrial në Livadicë të Podujevës. I pyetur nga gazetarët për situatën politike, Kurti nuk dha përgjigje, por foli për hollësitë e projektit,

duke përmendur sipërfaqen, gjatësinë e rrugës dhe afatin e përfundimit të punimeve. “Kryesorja është 30 hektarë, 4.6 kilometra rrugë, qendra e kompetencës në anën tjetër edhe 350 ditë punë, parku industrial në Livadicë po mbyllet, urime të gjithëve për këtë gurthemel”, ka thënë Kurti.

Hoti: Jemi të gatshëm për një president të pranueshëm për të gjitha palët

Ndërsa deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Avdullah Hoti, ka deklaruar se LDK-ja është e gatshme të kontribuojë në zgjidhjen e ngërçit institucional dhe në zgjedhjen e presidentit të vendit. Hoti ka bërë me dije se partia ka hequr dorë nga kërkesa për balancë institucionale, duke kërkuar që fillimisht të konstituohet Kuvendi dhe të formohet qeveria, ndërsa për presidentin të gjendet një kandidat i pranueshëm për të gjitha palët. I pyetur nëse LDK-ja do të marrë pjesë në takimin e thirrur nga ushtruesja e detyrës së presidentes, Albulena Haxhiu, për të martën, ku pritet të diskutohet çështja e presidentit, Hoti ka deklaruar se për këtë do të ketë njoftim zyrtar nga partia. “Besoj se do të keni një njoftim zyrtar nga Lidhja Demokratike e Kosovës lidhur me këtë çështje”, ka thënë Hoti.

Ai ka treguar se brenda strukturave të LDK-së është diskutuar gjerësisht për këtë çështje dhe se është arritur në përfundimin që t’i jepet mundësi themelimit të institucioneve të vendit. “Kemi diskutuar gjerësisht për këtë çështje brenda strukturave të Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe kemi ardhur në përfundim që, në funksion të shterimit të situatës, t’i japim mundësi që të ecet përpara me themelimin e institucioneve të vendit dhe kemi hequr dorë nga kërkesa jonë, që besoj është legjitime, për çështje e balancës së institucioneve... Besoj se kërkesa jonë ka qenë legjitime për balancë të institucioneve por, duke u përballur me bllokadë të institucioneve në mënyrë jo ushtetuese, e kemi këtë nismë legjislative, ne kemi hequr dorë nga ajo kërkesa jonë dhe kemi treguar gatishmërinë tonë që, në fazën kur vijmë të diskutimi për ta zgjedhur presidentin, të jemi konstruktivë në gjetjen e një zgjidhjeje të përshtatshme dhe të pranueshme për gjithë spektrin politik”, ka deklaruar Hoti. Sipas tij, partia që ka dalë e para në zgjedhje i ka votat e mjaftueshme, bashkë me partnerët e saj, për ta zgjedhur kryetarin e Kuvendit dhe qeverinë. “Partia që ka dalë e para në zgjedhje i ka votat e mjaftueshme për të zgjedhur, bashkë me partnerët e saj, sigurisht, kryetarin e Kuvendit dhe qeverinë, dhe mandej për të hapur diskutimet për presidentin e vendit, dhe aty i kemi 60 ditë mandej për të kryer diskutimet

që, nëse mund të arrijmë te një kandidat që është i pranueshëm për të gjitha palët. Edhe ne, si Lidhje Demokratike e Kosovës, shprehim gatishmërinë tonë që të kontribuojmë në atë proces”, ka thënë ai.

Hoti ka theksuar se LDK-ja ka kërkuar dhe vazhdon ta kërkojë thirrjen e seancës konstituive të Kuvendit. “Edhe ne kemi kërkuar dhe vazhdojmë ta kërkojmë me ngulm thirrjen e seancës konstituive të Kuvendit. Nuk ka asnjë arsye për vonesat, por secila prej partive politike i ka, si të thuash, qasjet e veta, e ka mënyrën e vet të veprimit. Ne kemi këtë qasje, ne jemi LDK, asnjëherë nuk kemi, as nuk kemi promovuar, as nuk i kemi mbështetur, as nuk i kemi përdorur çfarëdo forme që është jashtë, si të thuash, filozofisë së veprimit tonë politik”, ka deklaruar Hoti.

Ai ka vlerësuar se ekziston hapësirë mes të gjitha forcave politike për zgjedhjen e një presidenti të pranueshëm për të gjitha palët. “Unë besoj që ka hapësirë në mes të gjitha forcave politike për t’i dhënë vendit një president që është i pranueshëm për të gjitha palët. Vetëm në këtë pikë tash ka mbetur hapësira për diskutim. Diskutimet e tjera nuk ka mbetur pra gatishmëri dhe as



hapësirë dhe as vullnet prej nesh që të bëhen”, ka përfunduar Hoti.

Tahiri: Do t’i shqyrtojmë veprimet politike në ditët e ardhshme

Presionit për zhblokimin e institucioneve i është bashkuar edhe Aleanca. Deputeti i Aleancës, Besnik Tahiri, ka deklaruar se partia e tij do t’i shqyrtojë veprimet politike në ditët dhe javët e ardhshme, pas zhvillimeve të fundit politike në vend. Tahiri ka bërë me dije se grupi parlamentar i Aleancës do të mbledhet për të diskutuar qasjen e mëtejshme të partisë, duke lënë të hapur mundësinë për veprime të reja politike. “Dëgjoni, ne si grup do të kemi një takim, grupi parlamentar. Do të shohim për veprimet tona politike si Aleancë. Për sa i përket veprimit politik, kjo do të shqyrtohet, do ta diskutojmë se si do t’i qasemi kësaj teme. Por kjo na detyron neve që të reflektojmë, respektivisht t’i mendojmë çka dhe si do të sillemi në ditët e javët e ardhshme”, ka deklaruar ai. Tahiri ka theksuar se Aleanca ka qenë ndër partitë e para që ka ofruar

HASANI: NGËRÇI I KUVENDIT, “NJOLLË E ZEZË” NË HISTORINË POLITIKE DHE KUSHTETUESE TË KOSOVËS

Prishtinë, 17 gusht - Ish-kryetari i Gjykatës Kushtetuese, Enver Hasani, ka kritikuar bllokadën institucionale në Kuvend dhe mënyrën e menaxhimit të seancës konstituive nga kryesuesi Avni Dehari. Hasani ka thënë se kjo situatë “do të mbahet mend gjatë si një njollë e zezë në historinë politike dhe kushtetuese të vendit”.

Sipas tij, një nga gabimet më të mëdha të politikës kosovare ka qenë mosparashikimi si vepër të veçantë penale i moszbatimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese.

Hasani ka deklaruar gjithashtu se Albulena Haxhiu nuk mund të jetë ushtruese e detyrës së presidentit dhe se, edhe sikur të ishte, nuk do të kishte të drejtë të ftonte partitë në konsultime për çështje politike, përveç rasteve që lidhen me caktimin e datës së zgjedhjeve”, ka thënë Hasani për “Express”.



Ai ka vlerësuar se nuk duhet të dërgohet një rast i ri në Gjykatën Kushtetuese për shkak të moskonstituimit të Kuvendit. Seanca konstituive, e cila nisi më 6 korrik, është ndërprerë dy herë dhe vazhdimi i saj nuk është thirrur, ndërsa LV-ja ka kërkuar paraprakisht marrëveshje për zgjedhjen e presidentit.

Hasani ka kritikuar këtë qasje, duke thënë se me këto veprime Albin Kurti “është duke ikur nga aneksi i Ohrit” me Serbinë.

Ai e ka cilësuar këtë marrëveshje si “detyrimi më i rëndë dhe më i poshtër ndërkombëtar i Kosovës që nga Kuvendi i Prizrenit i vitit 1945, një tradhti ndaj Kosovës, pa asnjë dyshim”.

respektivisht kërkesave të cilat, kur i shikon, i lexon, të gjitha janë të mira për Kosovën, të gjitha janë të realizueshme”, ka thënë Tahiri. Sipas tij, situata aktuale nuk përbën krizë kushtetuese, por krizë politike. “Unë mendoj që këtu nuk ka krizë kushtetuese, ka krizë politike”, ka theksuar Tahiri.

PDK-ja kërkon nga Dehari ta thërrasë sot për vazhdimin e seancës konstituive

Partia Demokratike e Kosovës (PDK) i është drejtuar sërish kryesuesit të seancës konstituive, Avni Dehari, me kërkesë për vazhdimin e seancës së Kuvendit. Deputetët e PDK-së, përmes një letre drejtuar Deharit, kanë kërkuar që seanca të vazhdojë sot (e martë) në orën 11:00. Në letër, PDK-ja ka shprehur shqetësimin për moskonstituimin e Kuvendit dhe respektimin e afateve kushtetuese e procedurale. “Moskonstituimi i Kuvendit brenda afatit të përcaktuar tashmë ka krijuar një situatë të rëndë të shkëljes së Kushtetutës dhe të mosrespektimit të aktgjyqimeve të Gjykatës Kushtetuese. Mosrespektimi i afateve dhe procedurave të përcaktuara me Rregulloren e

Kuvendit vetëm sa e thellon më tej këtë situatë”, është thënë në letrën e PDK-së.



LDK-ja refuzon takimin me Haxhiun, Abdixhiku: Për ne ajo është deputete, takohemi vetëm me Kurtin

Pas PDK-së dhe Aleancës, edhe LDK-ja ka refuzuar ftesën e ushtrueses së detyrës së presidentes, Albulena Haxhiu, për takimin konsultativ të thirrur për sot (e martë) në orën 09:00. Kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, e ka konfirmuar vendimin në një deklaratë për televizionin “Dukagjini”. Abdixhiku ka thënë se LDK-ja zhvillon takime me kryetarët e partive politike dhe se, në këtë rast, është e gatshme të takohet vetëm me kryetarin e Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti. “Ne takimet i zhvillojmë me kryetarët e partive, në këtë rast takimin e vetëm që mund ta bëjmë është me kryetarin e LV-së, Albin Kurtin. Në pikëpamjet tona, zonja Haxhiu është deputete e Kuvendit dhe, në këtë rrjedhë, ne mund të flasim vetëm me ata që janë përgjegjës për këtë punë”, ka thënë Abdixhiku. Me refuzimin e LDK-së, ftesa e Haxhiut për konsultime rreth krizës politike dhe institucionale nuk është pranuar nga asnjë prej partive kryesore politike.



Ferizaj: 61 gjoba për një javë, telefoni dhe shkelja e shenjave në krye të listës

FERIZAJ, 17 GUSHT - Njësia e motoçikletave, në kuadër të Njesisë së Komunikacionit Rrugor në Ferizaj, ka shqiptuar 61 gjoba për kundërvajtje në trafik gjatë javës së kaluar. Sipas Policisë së Kosovës, 12 gjoba janë shqiptuar për mosrespektim të shenjave të trafikut, tetë për përdorim të telefonit gjatë vozitjes, shtatë për

mosmbajtje të distancës së sigurisë, ndërsa pesë për shkelje të rregullave të peshores nga shoferët e kamionëve, 29 gjoba të tjera janë shqiptuar për kundërvajtje të ndryshme. Njësia e Motoçikletave ka bërë me dije se ka vepruar në tërë territorin e rajonit të Ferizajt, përfshirë Ferizajin, Kaçanikun, Shtimen, Shtërpçën dhe Hanin e

Elezit. Policia rajonale e Ferizajt u ka bërë thirrje pjesëmarrësve në trafik që t'i respektojnë rregullat dhe shenjat e komunikacionit, ta mbajnë distancën e sigurisë dhe ta shmangin përdorimin e telefonit gjatë drejtimit të automjetit. “Policia rajonale e Ferizajt apelon te të gjithë pjesëmarrësit në trafik që të respektojnë rregullat dhe shenjat

e komunikacionit, të mbajnë distancën e sigurisë dhe të shmangin përdorimin e telefonit gjatë drejtimit të automjetit. Kujdesi, përqendrimi dhe respektimi i rregullave të trafikut shpëtojnë jetë. Udhëtoni me përgjegjësi dhe kontribuoni për një trafik më të sigurt për të gjithë”, është thënë në apelin e policisë.



ZEMAJ: QINDRA PACIENTË ME KANCER PO DETYROHEN T’I BLEJNË VETË BARNAT

PRISHTINË, 17 GUSHT - Deputeti i LDK-së, Armend Zemaj, ka ngritur shqetësimin për mungesën e barnave për terapitë e pacientëve me kancer, duke thënë se qindra prej tyre po detyrohen t’i blejnë vetë me paratë e tyre. Përmes një postimi në rrjetet sociale, Zemaj ka kritikuar menaxhimin e furnizimit me barna, duke theksuar se për këtë qëllim janë ndarë miliona euro përmes procedurave tenderuese. “Qindra pacientë me kancer po detyrohen t’i blejnë vetë barnat për terapi, në mungesë të tyre, edhe pse për furnizim me barna

janë dhënë miliona euro përmes tenderëve”, ka shkruar Zemaj. Ai e ka akuzuar pushtetin për krijimin e, siç e ka quajtur, një monopoli në sektorin farmaceutik, nga i cili, sipas tij, përfitojnë kompani të caktuara. Zemaj ka pretenduar se këto kompani janë të lidhura me zyrtarë të Ministrisë së Shëndetësisë, duke kritikuar mungesën e barnave për pacientët. “E kemi thënë vazhdimisht se ka para më shumë, por ka monopol të madh, nga i cili ka fitime të mëdha për kompani të veçanta farmaceutike të lidhura me



pushtetin, direkt me udhëheqës në MSh, e ish vartës të këtij sektori jetik, ndërsa për pacientët ka shumë më pak barna dhe, sigurisht, kjo është barrë e rëndë për familjet e tyre e gjepin e varfër të qytetarëve të Kosovës”, ka shkruar ai. Zemaj e ka ndërlidhur këtë çështje edhe me krizën politike në vend, duke pretenduar se shumica parlamentare nuk është e interesuar për konstituimin e Kuvendit pasi, sipas tij, nuk dëshiron mbikëqyrje dhe llogaridhënie për mënyrën se si menaxhohen fondet dhe shërbimet publike.

“LINJA E JETËS” PROTESTON KUNDËR RAPORTIMIT TË VETËVRASJEVE: KËRKON MBROJTJEN E PRIVATËSISË SË VIKTIMAVE



PRISHTINË, 17 GUSHT - Organizata “Linja e Jetës” ka protestuar kundër mënyrës së raportimit të rasteve të vetëvrasjeve dhe publikimit të informatave private të viktimave dhe familjeve të tyre. Drejtori i organizatës, Bind Skeja, ka kritikuar portalin “Sinjali”, duke pretenduar se publikimi i rasteve tragjike dhe informatave

të ndjeshme bëhet për rritjen e shikueshmërisë dhe klikimeve. Skeja ka ngritur shqetësime edhe për mungesën e transparencës rreth pronësisë, gazetarëve dhe financimit të portalit. Ai ka përmendur raste kur, sipas tij, janë ripublikuar video dhe informacione private të personave që kanë tentuar

vetëvrasjen ose kanë humbur jetën. Sipas tij, raportime të tilla u shkaktojnë presion shtesë familjeve në periudhën e tyre të zisë dhe cenojnë dinjitetin e viktimave. “Linja e Jetës” ka deklaruar se protesta është organizuar në mbështetje të familjeve dhe individëve që, sipas organizatës,

janë prekur nga këto raportime. Skeja u ka bërë thirrje institucioneve dhe shoqërisë që të reagojnë ndaj mënyrës së raportimit të rasteve të vetëvrasjeve dhe ta mbrojnë privatësinë e qytetarëve. Ai ka kërkuar gjithashtu nga bizneset që reklamojnë në “Sinjali” ta ndërpresin bashkëpunimin me

portalin. Organizata ka paralajmëruar se do të ndërmarrë edhe hapa të tjerë për të kërkuar drejtësi dhe ndryshim të praktikave të raportimit. Skeja ka theksuar se qëllimi i tyre është që familjet e tjera të mos përballen me publikimin e informatave private dhe cenimin e dinjitetit pas rasteve tragjike.

152 lindje në Gjinekologjinë e QKUK-së gjatë një jave, në mesin e tyre 5 binjakë

PRISHTINË, 17 GUSHT - 152 lindje janë realizuar gjatë javës së kaluar në Klinikën e Gjinekologjisë dhe Obstetrikës në Qendrën Klinike dhe Universitare të

Kosovës (QKUK). Sipas njoftimit të QKUK-së, 90 lindje kanë qenë natyrale, ndërsa 62 përmes operacionit cezarian. Gjatë kësaj periudhe janë regjistruar

edhe 5 lindje me binjakë, ndërsa në total kanë ardhur në jetë 157 foshnja: 85 djem dhe 72 vajza. “Klinika e Gjinekologjisë dhe Obstetrikës vazhdon të ofrojë

kujdes dhe shërbime profesionale për nënat dhe të porsalindurit, duke garantuar shëndetin dhe mirëqenien e tyre gjatë gjithë procesit”, ka njoftuar QKUK-ja.



‘HAPJA E URËS SË IBRIT, HAP HISTORIK DREJT LUFTIMIT TË TENDENCAVE TË SERBISË’

PRISHTINË, 17 GUSHT - Ish-presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka mirëpritur konfirmimin nga Brukseli se janë përbushur kushtet për hapjen e urës kryesore mbi lumin Ibër në Mitrovicë. Osmani ka theksuar se ndarja e Mitrovicës për më shumë se 27 vjet ka sjellë pasoja të shumta, përfshirë pasiguri, probleme në sundimin e ligjit dhe, sipas saj, ka mundësuar spastrimin etnik të shqiptarëve dhe uzurpimin e pronave të tyre. “Për më shumë se 27 vjet, ndarja e Mitrovicës, përveçse krijoi pasiguri dhe probleme në sundimin e ligjit, mundësoi spastrimin etnik të shqiptarëve dhe uzurpimin e pronave të tyre, e njëkohësisht i dha Serbisë alibi për të vazhduar me ëndrrat e saj hegjemoniste për ndarjen e Kosovës”, ka shkruar ajo në “Facebook”.

Osmani ka thënë se hapja e urës dhe qarkullimi i lirshëm mbi të përbëjnë, përveç të tjerash, një “hap historik drejt luftimit të tendencave të Serbisë për gllabërim terriroresh”. “Prandaj, qarkullimi i lirshëm mbi urën kryesore të lumit Ibër, përveçse bashkon njerëz, mbi të gjitha është një hap historik drejt luftimit të tendencave të Serbisë për gllabërim terriroresh. Përkundër vonesave të mëdha, ky hap do të ndihmojë në rritjen e nivelit të sigurisë dhe paqes së qëndrueshme në vendin tonë”, ka shkruar Osmani.

Në fund, Osmani ka shprehur

mirënjohje për të gjitha institucionet e angazhuara ndër vite në këtë proces, duke veçuar Policinë e Kosovës. “Mirënjohje për të gjitha institucionet e angazhuara ndër vite për të arritur deri këtu, e në veçanti për Policinë e Kosovës, e cila vazhdon të mbajë barrën kryesore për sigurinë në çdo pëllëmbë të territorit tonë dhe për çdo qytetar të vendit tonë”, ka theksuar Osmani.

Ndërsa deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Arben Gashi, ka thënë se situata në veri të Kosovës ka ndryshuar, por ka paralajmëruar se vendi tash përballet me rrezik më të madh juridik dhe me një situatë më të ndjeshme në dialog.

Gashi ka thënë se “rreziku juridik është më i madh se më parë”, duke kërkuar ruajtjen e status quo-së së re në veri dhe forcimin e pozitës juridike të Kosovës. “Kur thoja se gjendja faktike në veri ka ndryshuar, dhe se detyra jonë është ta ruajmë këtë status quo të re, ta përmirësojmë dhe njëkohësisht të luftojmë për ta forcuar pozitën juridike të Kosovës, shumëkush më sulmonte, madje edhe nga brenda. Sot, rreziku juridik është më i madh se më parë. Bisedimet janë më të ndjeshme e më të rrezikshme. Ndërsa arkitektura e sigurisë botërore po ndryshon dhe kjo do të ndikojë drejtpërdrejt edhe në rajonin tonë”, ka shkruar ai në një postim në Facebook.

Gashi ka thënë se Kosovës i



duhet “maturi, strategji dhe përgjegjësi shtetërore”. “Duhet ta ruajmë atë që kemi arritur, ta forcojmë pozitën tonë juridike e ndërkombëtare dhe, mbi të gjitha, të jemi të përgatitur për çdo zhvillim”, ka shkruar Gashi. Ai ka vënë theks të veçantë edhe te raportet me aleatët. “Raportet speciale me aleatët nuk janë luks politik. Janë interes jetik dhe garanci e sigurisë së Kosovës”, ka shkruar Gashi. Edhe kryetari i Mitrovicës, Faton Peci, ka reaguar pas përbushjes së kriterëve për

hapjen e urës së Ibrit, duke e cilësuar këtë zhvillim si një kapitull të ri për Mitrovicën dhe Kosovën. “Hapja e urës së Ibrit është kapitull që shkruan historinë përtej Kosovës e që përfundimisht varros idenë e krisur për ndarjen e veriut”, ka deklaruar ai. Peci, përmes një postimi në “Facebook”, ka thënë se kriteret për hapjen e urës janë përbushur falë, siç është shprehur ai, këmbënguljes përballë pengesave dhe trysnisë. “Kriteret për hapjen e urës u përbushën nga

këmbëngulësia përballë çdo pengese e trysnie”, ka shkruar Peci.

Ai ka kujtuar gjithashtu zotimin e bërë gjatë fushatës së fundit, së bashku me kryeministrin Albin Kurti, për hapjen e një kapitulli të ri për Mitrovicën. Sipas Pecit, hapja e urës së Ibrit përbën një moment historik përtej kufijve të Kosovës dhe shënon fundin e idesë për ndarjen e veriut. Në fund, kryetari i Mitrovicës ka uruar qytetarët dhe Kosovën për këtë zhvillim.

GJINI NGRE SHQETËSIMIN PËR INFILTRIMIN E SHËRBIMEVE SEKRETE NË INSTITUCIONET E KOSOVËS



PRISHTINË, 17 GUSHT - Kryetari i Aleancës, Ardian Gjini, ka ngritur shqetësimin për, siç ka thënë, infiltrimin e shërbimeve sekrete armike në institucionet e Kosovës dhe ndikimin e tyre në zhvillimet politike e shoqërore në vend.

Në një reagim të publikuar në “Facebook”, Gjini ka thënë se kjo tashmë është bërë e evidente, duke iu referuar edhe rasteve të personave të arrestuar nën dyshimet për spiunazh. “Spiunët tanimë edhe të arrestuar, sikurse ky Fehim Sali, janë me qasje në zyrtarë më të larta shtetërore dhe po ndikojnë drejtpërdrejt në zbehjen e shtetit dhe demokracisë”, ka shkruar Gjini. Sipas tij, ndikimi i këtyre rrjeteve nuk kufizohet vetëm brenda institucioneve, por shtrihet edhe përmes propagandës dhe rrjeteve sociale.

Gjini ka renditur disa qëllime që, sipas tij, synohen përmes kësaj lufte hibride: fragmentimi i

shoqërisë deri në nxitjen e konfliktit të brendshëm, dëmtimi i historisë dhe figurave kombëtare, pengimi i zhvillimit ekonomik, dëmtimi i marrëdhënieve me vendet mike dhe krijimi i një klime të pashpresës tek qytetarët. “Kjo është qëllimi i shërbimeve armiqësore dhe ky kurs po ndiqet tash e shumë vite, nga brenda sistemit dhe përmes luftës hibride, kryesisht propagandës elektronike”, ka deklaruar ai.

Në fund, Gjini ka ngritur pyetjen se sa persona të tjerë të dyshuar për lidhje me shërbime të huaja mund të jenë emëruar në pozita të rëndësishme shtetërore. “Një i arrestuar për spiunazh si Fehim Sali, i cili ishte emëruar edhe në Këshillin Konsultativ për Komunitete, duhet të ngrinte pyetjen kryesore: Edhe sa spiunë të tjerë mund të jenë të emëruar në majat e pushtetit?”, ka shkruar Gjini.

KURTI: SYNOJMË TA TRANSFORMOJMË EKONOMINË DHE TA FORCOJMË PRODHIMIN VENDOR

PODUJEVË, 17 GUSHT - Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, ka deklaruar se synimi i qeverisë është transformimi i ekonomisë së Kosovës, forcimi i prodhimit vendor dhe rritja e eksporteve në tregjet evropiane dhe ndërkombëtare. Kurti i ka bërë këto deklarata në ceremoninë e fillimit të punimeve për ndërtimin e Parkut Industrial në fshatin Livadicë të komunës së Podujevës, të organizuar nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT).

Ai ka vlerësuar se parqet industriale synojnë t'u krijojnë mundësi bizneseve vendore për zgjerim të kapaciteteve, pjesëtarëve të diasporës për të investuar në vendlindje, si dhe investorëve të huaj për të zhvendosur një pjesë të prodhimit të tyre në Kosovë. “Synimi ynë si qeveri është ta transformojmë ekonominë e Kosovës, ta forcojmë prodhimin vendor dhe të krijojmë sa më shumë produkte në lloje dhe në numër ‘Made in Kosova’. Jo vetëm t'i zëvendësojmë importet, por edhe të rrisim eksportet në tregjet



evropiane dhe ndërkombëtare. Parqet industriale janë të menduara për bizneset vendore, të cilat duan të zgjerohen dhe të rrisin kapacitetet e tyre, për qytetarët tanë nga diaspora që duan të sjellin kapitalin dhe përvojën e tyre

në vendlindje, si dhe për investorët e huaj që shohim mundësi për të zhvendosur një pjesë të prodhimit të tyre në Kosovë. Kosova ofron një sërë përparësish për investorët. Sot fillojmë me punime, ndërsa së shpejti pres që ky

park të bëhet shtëpi e madhe e re për bizneset”, ka thënë Kurti.

Ndërsa ministrja në detyrë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Mimoza Kusari-Lila, ka deklaruar se ekonomia e Kosovës është dyfishuar që

nga viti 2019, ndërsa ka theksuar nevojën për zhvillimin e infrastrukturës industriale dhe rritjen e prodhimit vendor. “Është fakt se ekonomia e Kosovës që nga viti 2019 është dyfishuar, shërbimet tona kanë arritur eksportin deri në 4 miliardë euro, ndërsa ende kemi sfida me deficitin e lartë të produkteve. Për ne është shumë e rëndësishme që infrastrukturën industriale ta zhvillojmë, të ofrojmë mundësi të punës dhe prodhimit në Kosovë. Ministria është duke u angazhuar në aktivizimin e 16 zonave industriale”, ka thënë ajo.

Ndërsa kryetari i komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, e ka cilësuar Parkun Industrial një prej projekteve më të rëndësishme ekonomike për komunën. “Një prej projekteve ekonomike më të rëndësishme në komunën tonë. Pas një pune relativisht të gjatë, më në fund po e fillojmë punën dhe po presim që fundin e vitit të ardhshëm bizneset tona, investorët tanë do ta kenë një shtëpi të vetën, një mundësi shtesë”, ka thënë Bulliqi.

KOSOVA ME MË SË SHUMTI TURISTË NË SHQIPËRI, PËRBËN 15 PËR QIND TË VIZITORËVE TË HUAJ

TIRANË, 18 GUSHT - Numri i vizitorëve të akomoduar në strukturat turistike në Shqipëri është rritur 17 për qind në qershor krahasuar me të njëjtin muaj të vitit të kaluar, ndërsa net-qëndrimet janë shtuar 9.8 për qind, sipas të dhënave të publikuara nga INSTAT për Strukturat Akomoduese.

Rritja ishte më e theksuar te vizitorët e huaj. Numri i tyre është rritur 20.6 për qind krahasuar me qershorin e vitit 2025, ndërsa vizitorët rezidentë janë shtuar 7 për qind. Net-qëndrimet e të huajve janë rritur 9.2 për qind, ndërsa ato të rezidentëve 11.8 për qind.

Të dhënat e qershorit vijnë pas një ecurie me luhatje të turizmit gjatë këtij viti, ku dinamika ka ndryshuar nga muaji në muaj. Operatorët turistikë presin që në tërësi sezoni të ketë një ecuri të ngjashme, por bilanci më i plotë i sezonit do

të mund të shihet pas përfundimit të muajve kryesorë të verës.

Në qershor rritja e vizitorëve të huaj ishte më e dukshme në zonat bregdetare. Numri i tyre ka arritur në 323 426, nga 253 867 në të njëjtin muaj të vitit të kaluar, që paraqet rritje rreth 27.4 për qind. Në zonat jobregdetare numri është rritur në 122 420, nga 115 816, ose rreth 5.7 për qind.

Hotelet dhe strukturat e ngjashme kanë pritur 401 836 vizitorë të huaj, krahasuar me 336, 26 në qershor 2025. Në akomodimet për pushime dhe strukturat e tjera afatshkurtra, numri i vizitorëve të huaj është rritur në 39 457, nga 27 227 një vit më parë. Norma e shfrytëzimit të dhomave në hotele arriti në 41.3 për qind, nga 39.5 për qind në qershor 2025, duke shënuar rritje prej 1.8 pikë përqindje.



Dogana e Kosovës arkëton mbi 1.15 miliard euro të hyra për shtatë muaj

PRISHTINË, 17 GUSHT - Dogana e Kosovës ka arkëtuar mbi 1.15 miliard euro të hyra bruto gjatë periudhës janar-korrik 2026, duke shënuar rritje krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Sipas të dhënave të doganës, të hyrat bruto në shtatë muajt e parë të vitit kanë arritur në 1 153 076 683 euro, ndërsa në të njëjtën periudhë të vitit 2025 ishin 1 085 940 460 euro. Kjo paraqet rritje prej

6.18-përqindësh, apo rreth 67.14 milionë euro më shumë se një vit më parë.

Rritje është shënuar në të gjitha kategoritë kryesore të të hyrave. Nga taksa e doganës janë mbledhur 110.61 milionë euro, krahasuar me 103.53 milionë euro në vitin 2025, që paraqet rritje prej 6.84-përqindësh. Nga akciza janë mbledhur 366.16 milionë euro, nga 352.05 milionë euro sa ishin në

periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, me rritje prej 4-përqindësh. Ndërsa të hyrat nga TVSh-ja kanë arritur në 673.47 milionë euro, krahasuar me 628.12 milionë euro në vitin 2025, duke shënuar rritje prej 7.21-përqindësh. Dogana e Kosovës ka thënë se rritja e të hyrave është rezultat i administrimit dhe mbledhjes së të hyrave, forcimit të kontrolleve doganore,

përmirësimit të efikasitetit operacional dhe zbatimit të legjislacionit doganor. “Rritja e të hyrave reflekton punën e vazhdueshme të Doganës së Kosovës në administrimin dhe mbledhjen e të hyrave, forcimin e kontrolleve doganore, përmirësimin e efikasitetit operacional dhe zbatimin e legjislacionit doganor. Dogana e Kosovës mbetet e përkushtuar në rritjen e efikasitetit,



digjitalizimin e proceseve dhe lehtësimin e tregtisë së ligjshme, duke garantuar njëkohësisht mbrojtjen e interesave financiare të Republikës së Kosovës”, ka njoftuar Dogana e Kosovës.

SONDAZHI I FINANCIAL TIMES GODET TRUMPIN, 53% E AMERIKANËVE THONË SE FINANCAT U JANË PËRKEQËSUAR

Një sondazh i Financial Times ka rrëzuar pretendimet e administratës Trump se gjendja ekonomike e amerikanë u përmirësua gjatë vitit të kaluar. “A do të thoshit se ndiheni më mirë apo më keq nga pikëpamja financiare, që kur Donald Trump mori detyrën në Shtëpinë e Bardhë në janar 2025?” ishte pyetja e drejtuar në anketë, ku përgjigja e votuesve të regjistruar ishte e ashpër dhe e drejtpërdrejtë: 53% e tyre thanë se financat në fakt, u janë përkeqësuar që nga rikthimi i Donald Trump në Shtëpinë e Bardhë. Pakënaqësia është e dukshme edhe mes votuesve të pavarur, ku 57% deklarojnë se janë më keq financiarisht, ndërsa një e katërta e votuesve republikanë shprehen gjithashtu të pakënaqur.

Sondazhi, vjen më pak se tre muaj para zgjedhjeve të mes mandatit në SHBA dhe tregon se inflacioni dhe kostoja e jetesës po kthehen në çështje të rëndësishme elektorale. Edhe pse inflacioni aktual është 3,4%, më i ulët se në periudha të caktuara të mandatit Biden, votuesit amerikanë duket se kanë më shumë besim te demokratët për menaxhimin e inflacionit dhe koston e jetesës. Për herë të parë, demokratët kanë avantazh edhe në çështjet e punësimit dhe ekonomisë, fusha që tradicionalisht kanë favorizuar republikanët. Rezultatet përbëjnë një sinjal shqetësues për Trumpin dhe republikanët, pasi gjendja ekonomike dhe kostoja e jetesës mund të ndikojnë drejtpërdrejt në rezultatin e zgjedhjeve të nëntorit



ARABIA SAUDITE NDRYSHON STRATEGJINË E EKSPORTIT TË NAFTËS, EGJIPTI FITON ROL PARËSOR



Arabia Saudite po përshtat mënyrën se si eksporton naftën drejt tregjeve ndërkombëtare, ndërsa pasiguria rreth Ngushticës së Hormuzit dhe Detit të Kuq po rrit rëndësinë e rrugëve alternative për transportin energjetik. Në këtë strategji të re, Egjipti po fiton një rol gjithnjë e më të rëndësishëm, veçanërisht përmes terminalit të Sidi Keririt në Mesdhe dhe sistemit të tubacioneve SUMED. Fokusi aktual është te menaxhimi i ngarkesave saudite për muajin shtator. Saudi Aramco ka kaluar për disa klientë aziatikë në një shpërndarje më fleksibile dhe ad

hoc të sasive, në vend të procesit standard mujor. Ky ndryshim tregon vështirësitë që po has Arabia Saudite në planifikimin e eksporteve, në një periudhë kur dy prej arterieve më të rëndësishme detare për tregtinë globale të energjisë janë nën presion. Problemi kryesor për Riadin është gjeografik. Në lindje ndodhet Ngushtica e Hormuzit, përmes së cilës kalon një pjesë e madhe e naftës së eksportuar nga Gjiri Persik. Në perëndim ndodhet Deti i Kuq, ndërsa më në jug është Bab el-Mandeb, ku rreziqet për anijet tregtare kanë komplikuar transportin. Në këtë situatë, Egjipti ofron një

alternativë strategjike. Përmes sistemit SUMED, nafta bruto mund të transportohet nga zona e Ain Sokhnës në Detin e Kuq drejt Sidi Keririt në bregdetin mesdhetar të Egjiptit. Kjo rrugë lejon shmangien e Bab el-Mandeb dhe redukon varësinë nga itineraret tradicionale detare. Aramco ka ofruar tashmë ngarkesa me pikë ngarkimi në Sidi Kerir. Për blerësit aziatikë, megjithatë, ky opsion sjell një ndryshim të rëndësishëm në ekonominë e transportit. Pasi nafta arrin në Mesdhe, ajo duhet të përshkojë një rrugë më të gjatë detare për të mbërritur në tregjet e Azisë.

Kjo situatë po tërheq vëmendje të veçantë edhe në tregun e transportit detar. Sa më shumë fuçi të transportohen përmes rrugëve më të gjata ose më komplekse, aq më shumë rriten “ton-miljet” e kërkuara. Kjo mund të kufizojë kapacitetin e disponueshëm të cisternave për periudha më të gjata dhe të ndikojë në ekuilibrin e tregut të transportit midis Gjirit Persik, Mesdheut dhe Azisë. Përdorimi i Sidi Keririt nuk do të thotë se ky terminal do të zëvendësojë qendrat kryesore saudite të eksportit. Megjithatë, ai tregon se Riadi po përpiqet të krijojë alternativa në rast se një

prej arterieve kryesore detare bëhet më e vështirë për t'u përdorur ose shumë e kushtueshme. Në të njëjtën kohë, përdorimi më i madh i infrastrukturës perëndimore të eksportit të Arabisë Saudite dhe i rrjetit energjetik egjiptian i jep Riadit një nivel shtesë fleksibiliteti. Korridori që lidh Detin e Kuq me Mesdheun përmes Egjiptit po shfaqet kështu si një alternativë strategjike ndaj varësisë nga Ngushtica e Hormuzit, ndërsa zhvillimet në transportin detar mund të kenë pasoja më të gjera për tregjet globale të naftës.

FIGURA KYÇE NË HIJE E NEGOCIATAVE: KUSH ËSHTË KONTAKTI SEKRET I TRUMPIT ME GARDËN REVOLUCIONARE TË IRANIT?



Administrata Trump përdori një kanal të fshehtë komunikimi me udhëheqjen e Gardës Revolucionare Islamike të Iranit (IRGC), duke anashkaluar përkohësisht negociatorët zyrtarë iranianë, në përpjekje për t'i dhënë fund luftës mes SHBA-ve dhe Iranit.

Sipas tre burimeve me dijeni të drejtpërdrejtë për zhvillimet, Shtëpia e Bardhë iu drejtua presidentit të Rajonit të Kurdistanit të Irakut, Nechirvan Barzani, për të vendosur kontakt me drejtuesit e fuqishëm të IRGC-së.

Ky zhvillim, i cili nuk ishte raportuar më parë, tregon vështirësitë me të cilat është përballur administrata amerikane gjatë negociatave me Teheranin, veçanërisht për shkak të pasigurisë së Washingtonit se kush kishte realisht autoritetin për të marrë vendime në emër të Iranit.

Washingtoni dyshoi te negociatorët iranianë

Pas një armëpushimi më 8 prill dhe një samiti të zhvilluar disa ditë më vonë në Islamabad, SHBA-të dhe Irani nisën përpjekjet për të negociuar përfundimin e luftës.

Në fillim të majit, administrata Trump besonte se një marrëveshje ishte pranë. Por përgjigjja e Iranit u vonua për më shumë se dhjetë ditë. Negociatorët amerikanë nisën të dyshonin se ministri i Jashtëm iranian Abbas Araghchi dhe kryetari i parlamentit Mohammad Bagher Ghalibaf nuk kishin autoritetin

e plotë për të arritur një marrëveshje dhe se vendimet e tyre mund të ishin duke u bllokuar nga Garda Revolucionare. Kjo e shtyu Shtëpinë e Bardhë të kërkonte një kanal të drejtpërdrejtë me udhëheqjen e IRGC-së.

Gabbard kontaktoi Barzanin

Rreth 10 majit, drejtoresha e atëhershme e Inteligjencës Kombëtare amerikane, Tulsi Gabbard, kontaktoi Nechirvan Barzanin.

Sipas dy burimeve me dijeni për bisedën, Gabbard i kërkoi Barzanit të ndihmonte në vendosjen e kontaktit me komandantin e Gardës Revolucionare, gjeneralin Ahmad Vahidi.

Barzani konsiderohej një ndër personat e paktë që kishin besimin e figurave të rëndësishme si në Washington, ashtu edhe në Teheran. Gjatë luftës Iran-Irak, ai kishte jetuar në Iran dhe kishte studiuar në Universitetin e Teheranit. Ai flet rrjedhshëm persisht dhe ka lidhje personale me zyrtarë të lartë iranianë, përfshirë figura të rëndësishme të IRGC-së.

Ish-këshilltari amerikan për Lindjen e Mesme, Brett McGurk, e përshkroi Barzanin si një figurë pragmatike, të respektuar në rajon dhe me kontakte të shumta si në Teheran, ashtu edhe në Washington.

Sipas burimit, Gabbard i bëri të qartë Barzanit se po vepronte me miratimin e pres-

identit Trump dhe të nënpresidentit JD Vance.

Qëllimi i Shtëpisë së Bardhë ishte të kuptonte nëse udhëheqja e IRGC-së mbështeste atë që po negocionin Araghchi dhe Ghalibaf apo kishte kërkesa të tjera.

Kontakti sekret me gjeneralin Vahidi

Barzani pranoi të ndërmjetësonte dhe kontaktoi personat e tij në Gardën Revolucionare. Ai kërkoi të fliste drejtpërdrejt me gjeneralin Ahmad Vahidi. Sipas burimeve, pala iraniane pranoi.

Më 14 maj, një zyrtar i IRGC-së mbërriti në zyrën e Barzanit në Erbil, kryeqytetin e Kurdistanit irakian, duke marrë me vete një telefon të enkriptuar për të zhvilluar një komunikim të sigurt.

Gjatë bisedës, Barzani e pyeti Vahidin nëse ishte në një linjë me negociatorët iranianë. Sipas një burimi me dijeni të drejtpërdrejtë, Vahidi konfirmoi se ishte dakord me ta dhe se Garda Revolucionare mbështeste zgjidhjen e krizës përmes negociatave.

Pas bisedës, Barzani kontaktoi menjëherë Gabbard dhe e informoi për përgjigjen e gjeneralit. Gabbard më pas ia përcolli informacionin Shtëpisë së Bardhë.

SHBA kërkoi negociata sekrete në Erbil

Pas këtij komunikimi, administrata Trump ndërmori një tjetër hap.

Sipas burimeve, Washingtoni i kërkoi Barzanit që të organizonte në Erbil negociata sekrete mes përfaqësuesve të lartë amerikanë dhe iranianë. Barzani ua përcolli propozimin palës iraniane.

Teherani nuk e përjashtoi plotësisht mundësinë, por shfaqti shqetësime serioze për sigurinë e delegacionit.

Zyrtarët iranianë dyshonin se intelijenca izraelite kishte një numër të madh asetesh në Kurdistanin irakian dhe kishin frikë se mund të bëheshin objektivi i një atentati në Erbil ose gjatë udhëtimit drejt dhe nga qyteti.

Për këtë arsye, takimi sekret në Erbil nuk u zhvillua.

Lufta ndryshoi ekuilibrat e pushtetit në Iran

Sipas raportimit, lufta ka ndryshuar ndjeshëm strukturën e pushtetit në Iran.

Vrasja e liderit suprem Ali Khamenei dhe e figurave të tjera të larta politike, e ndjekur nga rreth 40 ditë luftime, ka forcuar ndjeshëm ndikimin e Gardës Revolucionare në vendimmarrjen për sigurinë kombëtare dhe politikën e jashtme.

Pasiguria rreth gjendjes së liderit të ri suprem, Mojtaba Khamenei dhe mungesa e tij nga jeta publike gjatë javëve të para të luftës e kanë forcuar më tej pozicionin e komandantëve të IRGC-së.

Kjo ka krijuar një problem të madh për Uashingtonin: edhe nëse negociatat zhvillohen me zyrtarë të lartë të qeverisë iraniane, mbetet pyetja nëse ata

kanë autoritetin përfundimtar për të zbatuar një marrëveshje.

Negociatat aktualisht janë të bllokuara

Ndërkohë, ndërmjetësit nga Pakistani dhe Katari vazhdojnë të përcjellin mesazhe mes SHBA-ve dhe Iranit, por deri tani nuk ka pasur përparim të rëndësishëm.

Disa burime rajonale besojnë se pala pakistaneze mund të jetë duke dhënë një pasqyrë më optimiste të negociatave se sa e justifikojnë zhvillimet reale, me synimin për të krijuar një ndjenjë progresi dhe për të thyer ngërçin.

Në këtë situatë, Barzani mund të luajë sërish një rol.

Sipas një burimi me dijeni për çështjen, ai i ka dërguar së fundmi mesazhe Shtëpisë së Bardhë duke ofruar ndihmën e tij për rifillimin e negociatave mes SHBA-ve dhe Iranit.

Megjithatë, sipas McGurk, problemi kryesor nuk është gjetja e një ndërmjetësi të ri, por politika e Iranit lidhur me Ngushticën e Hormuzit, një çështje që sipas tij nuk pritet të ndryshojë së shpejti.

Zbulimi i këtij kanali sekret tregon se administrata Trump është përballur me një nga problemet më të ndërlikuara të negociatave me Teheranin: jo vetëm se çfarë kërkon Irani, por kush e ka realisht fuqinë për të thënë “po” dhe për ta zbatuar atë marrëveshje.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com





QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82



Lens mposht PSG-në dhe fiton Superkupën e Francës

PARIS, 17 GUSHT - Lens ka triumfuar në Superkupën e Francës, duke mposhtur Paris Saint-Germainin (PSG) me rezultat 1-0 në finale. Edhe pse ka mbetur me një lojtar më pak që nga pjesa e parë, Lens ka arritur ta ruajë epërsinë dhe ta sigurojë trofeun. Florian Thauvin ishte

heroi i skuadrës, duke shënuar golin e fitores në minutën e 32-të pas një aksioni të shpejtë, me asistimin e Udolit. Lens ka mbetur me dhjetë lojtarë në minutën e 39, kur Kylian Antonio është ndëshkuar me karton të kuq pas një ndërhyrjeje të rëndë. PSG-ja ka pasur mundësi të mira

për ta barazuar rezultatin, por Desire Doue ka dështuar të shënojë nga afërsia. "Parisienët" kanë arritur të shënojnë përmes Fabian Ruizit, por goli është anuluar për pozitë jashtë loje. Edhe Ousmane Dembele ka pasur një mundësi të mirë, por nuk arriti ta finalizojë. Në

minutën e 87 edhe PSG-ja ka mbetur me dhjetë lojtarë, pasi Nuno Mendes është ndëshkuar me karton të kuq pas një ndërhyrjeje të ashpër. Kësisoj, PSG-ja nuk ka arritur ta fitojë trofeun e dytë pas Superkupës së Evropës, ndërsa Lensi ka festuar një sukses të rëndësishëm.



SHUHEN DY EMRA EMBLEMATIKË TË FUTBOLLIT TË KOSOVËS, ERDOGAN CELINA DHE ZENUN BROVINA

PRISHTINË, 17 GUSHT - Futboli i Kosovës është përballur me një humbje të rëndë, pasi brenda të njëjtës ditë janë ndarë nga jeta dy prej emrave më të mëdhenj dhe më emblematikë të historisë së tij, Erdogan Celina dhe Zenun Brovina.

Lajmin për ndarjen nga jeta të dy legjendave e ka dhënë presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Agim Ademi, i cili ka shprehur ngushëllime për familjet, të afërmit dhe gjithë komunitetin e futbollit.

Erdogan Celina, i cili është ndarë nga jeta pas një sëmundjeje të shkurtër, ishte pjesë e brezit të artë të futbollit të Kosovës. Ai ka mbrojtur ngjyrat e Prishtinës dhe ishte pjesë e Trepçës në periudhën e saj historike, duke qenë pjesë edhe e finales së Kupës së Jugosllavisë në vitin 1978. Celina njihej jo vetëm për cilësitë e tij si futbollist, por

edhe për rolin e liderit dhe kapitenit. Pas përfundimit të karrierës si futbollist, ai vazhdoi kontributin në futboll si trajner, duke drejtuar Lirinë e Prizrenit dhe duke kontribuar edhe në ekipin kombëtar U21 të Kosovës.

Ndërkaq Zenun Brovina është ndarë nga jeta në moshën 84-vjeçare. Ai ishte një prej futbollistëve më të spikatur të gjeneratës së tij, ndërsa karrierën e kishte nisur te Vëllaznimi i Gjakovës. Më pas kishte luajtur edhe për Partizanin e Beogradit dhe Prishtinën si dhe kishte qenë kapiten i Reprezentacionit të Kosovës. Ademi ka vlerësuar lart kontributin e Brovinës, duke e cilësuar atë si një futbollist i jashtëzakonshëm dhe një figurë të respektuar të futbollit të Kosovës. "Është veçanërisht e dhimbshme që në të njëjtën ditë futbollit ynë u përball me humbjen e dy legjendave të tij. Pas ndarjes



nga jeta të Erdogan Celinës, morëm edhe lajmin për vdekjen e Zenun Brovinës, në moshën 84-vjeçare. Dy emra të mëdhenj, dy personalitete të jashtëzakonshme dhe dy histori të çmuara të futbollit kosovar, që tashmë i bashkohen kujtesës sonë sportive", ka shkruar Ademi

në telegram-ngushëllim. Sipas tij, të dy futbollistët kanë lënë pas një trashëgimi të çmuar dhe do të mbeten pjesë e historisë së futbollit të Kosovës. "Në emrin tim dhe të Komitetit Ekzekutiv të Federatës së Futbollit të Kosovës, u shpreh ngushëllimet më të sinqerta

familjes Brovina, të afërmeve, miqve dhe gjithë komunitetit të futbollit të Kosovës. Sot futbollit ynë po i përcjell për në përjetësi dy nga futbollistët e tij më të çmuar, Zenun Brovinën e Erdogan Celinën", ka shkruar Ademi në telegram ngushëllim.

RAMAJ HUAZOHET SËRISH TE COPENHAGENI

KOPENHAGË, 17 GUSHT - Portieri Diant Ramaj nuk do të jetë pjesë e Borussia Dortmundit për sezonin 2026/27, pasi është huazuar sërish te skuadra daneze e Copenhagenit. Ramaj është larguar nga klubi gjerman në formë huazimi,

ndërsa me Dortmundin ka kontratë deri në verën e vitit 2029. Huazimi i tij te Copenhageni tashmë është zyrtarizuar nga Dortmundi. Për 24-vjeçarin ky është rikthimi i dytë te skuadra elitare daneze, pasi edhe në



pjesën e dytë të sezonit 2024/25 ishte i huazuar te Copenhageni. Gjatë asaj periudhe Ramaj e ndihmoi skuadrën daneze të fitonte titullin e kampionit dhe Kupën. Sezonin e kaluar portieri ishte i huazuar te skuadra e

Bundesligës, Heidenheim, ndërsa huazimi te Copenhageni është i treti që prej transferimit të tij te Dortmundi. Ramaj iu bashkua Borussia Dortmundit në shkurt të vitit 2025 nga Ajaxi për shumën prej 7 milionë eurosh.

Benzema mund të largohet nga Al-Hilali, Inzaghi kërkon tjetër sulmues

RIAD, 17 GUSHT - E ardhmja e Karim Benzemas tek Al-Hilali është rikthyer në qendër të vëmendjes, pasi sulmuesi francez mund të largohet nga klubi saudit gjatë këtij afati kalimtar. Sipas gazetës spanjolle "AS", Benzema mund ta shkëpusë kontratën me Al-Hilalin, pasi trajneri Simone Inzaghi nuk e

konsideron ish-sulmuesin e Real Madridit pjesë qendrore e projektit të tij. Për këtë arsye, Benzema po shqyrton mundësinë e prishjes së kontratës, gjë që do ta bënte atë lojtar të lirë. Megjithatë, largimi i tij nuk është i thjeshtë. Një pjesë e konsiderueshme e pagës së Benzemas mbulohet nga Saudi

Pro League, që e bën të nevojshme një marrëveshje mes futbollistit, klubit dhe ligës saudite. Sipas "AS", Benzema ka kërkuar që t'i paguhet e gjithë paga e parashikuar për vitin e fundit të kontratës përpara se ta pranojë largimin. Kjo kërkesë, sipas raportimit, nuk është pritur pozitivisht nga

drejtuesit e Al-Hilalit dhe të ligës saudite. Ndërkohë, Al-Hilali po shqyrton edhe alternativat për sulmin. Emri kryesor në listën e klubit është ai i Ollie Watkinsit, sulmuesit anglez të Aston Villës, i cili ka kontratë me klubin deri në vitin 2028. Nëse arrihet marrëveshja për largimin e Benzemas, aventura e francezit



në Arabinë Saudite mund të përfundojë më herët nga sa ishte planifikuar.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjeipuneshpejter

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “ERCO-KS” SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810817223 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klijenti da društvo sa "ERCO-KS" D.O.O. Pristina donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810817223 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klijenti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability “ERCO-KS” L.L.C. with headquarters Pristina, has come to the decision to quit its business: 810817223 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgagor – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Egzon Halili shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Mjekësisë “Hysni Zajmi” Giakovë.

- Fortesa Mustafa shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme sh.m.l. "Ukshin Hoti" Krush e Madhe.

- Atdhe Gashi shpall të pavlefshme dëftesat diplomën si dhe certifikatën e diplomës të shkollës së mesme Teknike "28 Nëntori" Prishtinë.

- Valmir Karavidaj shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Gjergj Kastrioti" në Mazdrek.

- Elton Halili shpall të pavlefshme dëftesën e klasës së 11 të shkollës së mesme të lartë të mjekësisë "Dr. Xheladin Deda".

- Istref Hysni Nebiu shpall të pavlefshme Diplomën e Inxhinier i Diplomuar i Makineris në UB-me nr. 332.

- Shkëndije Lushaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.l.m."Hysni Zaimi" Gjakovë.

- Maurita Koca nga Bishtazhina KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të Gjmnazit "Hajdar Duishi" Gjakovë.

- Bedri Zeneli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën dhe certifikatën e notave të Gjmnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.


- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)



044 900 978 | 045 681 898

 [Sallon Depilimi Lume's Details](#)

 [lumesdetails](#)

 Mbrapa Teatr it, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Ermbotelladaora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

